

ALBANSKA

PËR TY QË JE PACIENT

**SKaPa – regjistër
kombëtar i kualitetit
brenda kujdesit
dentar**

Për më shumë informacion

Telefoni 054-61 50 00

www.skapareg.se

www.kvalitetsregister.se



REGJISTRI SUEDEZ
I KUALITETIT
PËR KARIES DHE
PARODONTIT

SVENSKT
KVALITETSREGISTER
FÖR KARIES
OCH PARODONTIT

Për të zhvilluar kualitetin e mjekësisë i raportojmë të dhënat e pacientit në **SKaPa**, një regjistër kombëtar i kualitetit për karies (vrime në dhëmb) dhe parodontit (rënia e dhëmbëve).

Regjistri i kualitetit ndihmon për një kualitet më të mirë

Regjistri i kualitetit në mjekësi ndihmon për njohuri të reja, për alternativën më të mirë të trajtimit në shumë fusha. Në regjistrat e kualitetit mblidhen të dhënat nga kontrollimi, trajtimi dhe rezultati për grupet e ndryshme të pacientëve, nga i gjithë vendi.

Ti ndihmon për një kujdes më të mirë!

Me të dhënat tua të pacientit ndihmon që të zhvillohet mjekësia. Sa më shumë që marrin pjesë, aq më të besueshme bëhen rezultatet. Më pas, rezultatet i përdorim në përmirësimin e punës tonë.

Ti je i/e mbrojtur nga sekretet zyrtar.

Të dhënat tua në regjistrin e kualitetit janë të mbrojtura nga sekretet zyrtar dhe ato trajtohen njësoj si të dhënat e historikut të mjekësisë.

Të dhënat hiqen nga regjistri, kur për ato, nuk ka më nevojë. Ligji mbi të dhënat kompjuterike të pacientit, rregullon trajtimin e të dhënave të pacientit në regjistrin e kualitetit.

Të dhënat tua të pacientit

Të dhënat për ty si pacient merren nga historiku yt i mjekësisë dentare. Vetëm ofruesi i mjekësisë ku ti shkon, ka të drejtë t' i ketë të dhënat e mjekimit tënd.

Të dhënat e pidentifikueshme mbi trajtimin tënd mblidhen bashkë me të dhënat e trajtimit të pacientëve të tjerë, për një ndjekje kombëtare në vazhdim. Të dhënat, po ashtu, mund të përdoren për qëllime hulumtuese.

Ti mund të kërkosh të hiqen të dhënat tua dhe t' i thuash jo regjistrimit tënd. Atëherë, kontakto trajtuesin tënd.

Nëse dëshiron më shumë informacion mbi SKaPa-n, mund të shikosh në uebfaqen e regjistrit ose kontakto SKaPa në telefonin 054-61 50 00.

Për të marrë një pjesë teksti (ekstrakt) me të dhënat e regjistruara në SKaPa, kontakto Hans Ramstedt, përfaqësues i të dhënave personale i Këshillit të qarkut Värmland, i cili kujdeset për pjesët e tekstit (ekstraktet) sipas 26 § të Ligjit mbi të dhënat personale, PuL. Hans Ramstedt është i arritshëm në telefonin 054-61 50 00.